

Tregtia Organike për Zhvillim – OT4D

Fondi për zhvillimin e bujqësisë organike në
Shqipëri

Udhëzimet

1. Objektivat e skemës së financimit

Fondi për zhvillimin e bujqësisë organike (SUOF) është pjesë e Programit të Zhvillimit të Tregtisë Organike (OT4D), i cili financohet nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe menaxhohet nga IFOAM-Organics International, së bashku me konsorciumin Helvetas-FiBL dhe me mbështetjen e partnerëve zbatues lokalë.

SUOF është një skemë e brendshme financimi e projektit, e krijuar për të bashkëfinancuar aktivitete që lidhen dhe rrisin impaktin në sektorin organik, me një potencial për të gjeneruar vlerë të shtuar të konsiderueshme për objektivat e programit dhe për tregjet organike lokale. Fondi është krijuar për të mbështetur iniciativat ekzistuese organike në tregjet organike lokale në Shqipëri. E njëjta do të implementohet edhe në Serbi.

Fondet e disponueshme do t'i alokohen bizneseve ekzistuese që paraqesin propozime me rezultatet më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit organik lokal në Shqipëri me fokus në sfidat e mëposhtme:

- Aksesimi në tregjet lokalë,
- Zhvillimi i zinxhirit(eve) të vlerave,
- Ofrimi i shërbimeve (inputet organike, asistenca teknike, etj.),

Pritet që aktivitetet e mbështetura të gjenerojnë lloje të ndryshme inovacionesh për të stimuluar zhvillimin e tregut dhe sektorit, duke adresuar drejtpërdrejt sfidat e sipërpërmendura. Aplikantët do të paraqesin propozime që adresojnë një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme:

- **Inovacionet tregtare** - zhvillimi i produkteve dhe etiketimi, krijimi i pikave të reja të shitjes ose skemave të shitjes, zhvillimi i materialeve promociionale ose marketingut dhe faqeve të internetit.
- **Inovacionet teknike** - përmirësime në prodhimin dhe/ose përpunimin, paketimin, pajisjet specifike të përpunimit, përcaktimin e standardeve të reja të prodhimit, ose shërbime të specializuara për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e produktit, etj.
- **Inovacionet institucionale** – zhvillimi i partneriteteve të reja të biznesit, partneriteteve të palëve të interesuara dhe rrjeteve të bashkëpunëtorëve, institucionalizimi i trajnimit të palëve të interesuara, zhvillimi i platformave të palëve të interesuara, tregjeve dhe panaiereve, konferencave etj.

Kontributet e SUOF prej 5,000 CHF dhe 10,000 CHF janë në dispozicion për llojin e mëposhtëm të përfituesve:

- Ndërmarrje të vogla dhe të mesme (SME) ose grupe fermerësh (shoqata dhe kooperativa të regjistruara ligjrisht) të angazhuara në zinxhirët e vlerave organike dhe të regjistruara në Shqipëri¹.
- Aplikantët duhet të jenë ose të certifikuar organik, në proces konvertimi në organik ose të kenë dorëzuar aplikimin e tyre për certifikim pranë një trupe certifikimi që vepron në vendin e tyre të operimit.
- Aplikantët duhet të angazhohen të ndjekin parimet organike të shëndetit, ekologjisë, kujdesit dhe drejtësisë të IFOAM-Organics International.

Aplikantët mund të dorëzojnë më shumë se një aplikim, por vetëm një aplikim do të jetë fitues për çdo aplikant.

¹ SME në Shqipëri përfshijnë entitetet që kanë më pak se 250 të punësuar dhe kanë të ardhura vjetore nën 250 milion Lek.

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të iniciativave lokale, tematikat/fushat e mëposhtme do të kenë prioritet në vendet:

Fushat prioritare të mbështetjes

SHQIPËRIA²

- Të ndihmohen fermat me përdorim të ulët të inputeve në konvertimin në bujqësi organike dhe iniciativat për të filluar prodhimin organik vendas, duke u fokusuar fuqimisht në planifikimin e prodhimit bazuar në kërkesën e tregut (procesi i planifikimit të prodhimit sipas specifikimeve të tregut).
- Mbështetje në procesin e prodhimit të mallrave bujqësore dhe përmirësimi i ambienteve/strukturave/pajisjeve të magazinimit, përpunimit dhe ndërtimi i objekteve për kapacitete më të larta të përpunimit.
- Lidhja me agroturizmin dhe aksesin në dyqanet me pakicë.

Bashkë-Financimi

Aplikanti kontribuon minimalisht me 30%³ të vlerës totale të propozimit, e cila do të plotësohet nga SUOF në 100% (për një kontribut maksimal prej 5.000 CHF ose 10.000 CHF). Nga shuma totale e propozimit, maksimumi 10% mund të jetë kontribut në natyrë (p.sh. koha e stafit). Në rastin e blerjes së pajisjeve, kontributi i SUOF-it mund të mbulojë maksimumi 50% të kostos së pajisjes.

Të gjitha aktivitetet e mbështetura duhet të zbatohen dhe përfundojnë brenda një viti pas nënshkrimit të marrëveshjes së grantit dhe në asnjë rast më vonë se 31 Tetor 2023.

Të gjitha aplikimet e miratuara do të marrin mbështetje shtesë përmes një këshilltari lokal për të zhvilluar më tej biznesin e tyre, planet e marketingut ose zbatimin e teknologjive të reja të përpunimit/prodhimit. Këshilltarët do të shoqërojnë zbatimin e aktiviteteve. Kostoja e shërbimeve këshillimore do të mbulohet drejtpërdrejt nga programi OT4D, përveç shumës së aprovuar nga granti.

2. Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes do të përdoren për të vlerësuar aplikimet:

- Ndikimi në zhvillimin e tregut** – potenciali pozitiv dhe efekti i pritshëm në zhvillimin e sektorit organik lokal, në terma të pritshmërisë së impaktit (sa ndikon) tek konsumatorët/klientët, përmirësim të kushteve për zhvillimin e zinxhirëve të vlerës, përmirësim të ndërgjegjësimit të konsumatorëve, etj.
- Ndikimi financiar dhe qëndrueshmëria** – propozimi duhet të shpjegojë qartë që kontributi financiar do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë në organizatë, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e tyre financiare. Qëndrueshmëria mjedisore e operacioneve (prodhimi, përpunimi, etj.) duhet të shpjegohet gjithashtu,
- Ndikimi Social** – aplikantët duhet të tregojnë se aktivitetet e tyre ose forcojnë dhe japin përfitime për komunitetin, dhe/ose mbështesin diversitetin gjinor dhe/ose kontribuojnë në angazhimin dhe praninë e të rinjve në bujqësi.

² Në rastin e Shqipërisë, ku prodhimi organik për tregun vendas është në një fazë fillestare zhvillimi, do të sigurohet një mbështetje në plotësimin e aplikimit dhe mbështetje për fermerët gjatë përgatitjes së të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

³ Bashkëfinancimi nënkupton (a) kontribut vetjak financiar të aplikantit dhe/ose kohë pune vetjake; (b) kontribut nga një klient (p.sh. pagesa e standës së panairit); (c) kontribut nga partnerët, sponsorë dhe donatorë të tjerë përveç atyre të Konfederatës Zviceriane.

- (d) **Zhvillimi i kapaciteteve** – aktivitetet e propozuara duhet të ndërtojnë dhe forcojnë kapacitetet kyçe që do të stimulojnë inovacionin e mëtejshëm dhe konkurrencën e aktorit(ve) të përfshirë ose të sektorit në tërësi.

Si parakusht për aplikim, iniciativat duhet të dëshmojnë se kanë kapacitetet dhe burimet për të siguruar që aktivitetet e propozuara do të zbatohen në mënyrë adekuate, në mënyrë të tillë që donatori (SECO) të jetë i sigurt që aktivitetet e propozuara do të zbatohet me efikasitet dhe do të jenë efçente. Për këtë, aplikantët duhet të paraqesin vlerësimin organizativ që gjendet në Aneksin 2.

3. Menaxhimi & Thirrja për aplikime

Përgjegjësia për menaxhimin e përgjithshëm të SUOF-it i takon IFOAM-Organics International, me mbështetjen e partnerëve zbatues lokalë. Partnerët zbatues vendorë do të sigurojnë që thirrja për aplikime të ketë një shtrirje adekuate tek palët e interesuar lokalë. Ata gjithashtu do të ofrojnë mbështetje në sqarimin e çdo pyetjeje që mund të lindë nga aplikantët. Partnerët zbatues lokalë në Shqipëri do të jenë përgjegjës për të siguruar një shtrirje të përshtatshme të thirrjes për aplikime, do të jenë pjesë e komisionit përzgjedhës dhe monitorimit të SUOF-it të suksesshëm.

Thirrja për aplikime do të postohet në faqen e internetit të OT4D (www.organictrade4development.org) dhe do të ndahet gjithashtu brenda rrjeteve lokale të bashkëpunimit, në gjuhën lokale. Thirrja do të jetë e hapur për të 2 vendet (Shqipëri dhe Serbi), por aplikimet do të vlerësohen veçmas nga një komitet lokal përzgjedhës, me përfaqësues të sektorëve organikë vendas, partnerët vendas zbatues, IFOAM-Organics International dhe SDC/ Ambasada Zviceriane. Zyra Qendrore e SECO do të sigurojë miratimin përfundimtar për aplikimet e përzgjedhura.

Pas përzgjedhjes, një këshilltar lokal do t'i caktohet secilit përfitues. Këshilltarët do të jenë të specializuar ose në këshillimin mbi njohuritë teknike, marketingun dhe/ose përmirësimin e kapaciteteve brenda iniciativës. Përzgjedhja e këshilltarëve do të bëhet nga partnerët zbatues vendas me mbështetjen e IFOAM – Organics International.

4. Procedura

4.1 Vlerësimi & procesi përzgjedhjes

Aplikantët do të dorëzojnë aplikimin me përshkrimin e propozimit të tyre, duke përdorur formatin e paraqitur në Aneksin 1. Aplikimet do të vlerësohen nga komisioni përzgjedhës. Këto propozime më pas vlerësohen duke përdorur kriteret e përzgjedhjes të përshkruara në Seksionin 2.

Aplikimet që nuk respektojnë numrin maksimal të faqeve, që nuk përmbajnë dokumentacionin e plotë, kanë mungesë në informacione të tjera të kërkuara ose i dorëzojnë aplikimet pas afatit të përcaktuar, nuk do të konsiderohen për vlerësim.

Aplikantët e përzgjedhur më pas do të ftohen të paraqesin një plan të detajuar aktiviteti dhe informacione shtesë ose sqarime për çdo pyetje që mund të ngrejë komisioni përzgjedhës.

SECO do të japë miratimin përfundimtar për të gjitha aplikimet e miratuara dhe më pas Marrëveshjet e Grantit do të nënshkruhen ndërmjet IFOAM-Organics International dhe aplikantëve të përzgjedhur.

4.2 Proçedura e detajuar dhe afatet kohore të procesit të aplikimit të SUOF

Aplikimi

Hapi	Proçedura	Koha
1	Hapja e thirrjes	8 Korrik 2022
2	Aplikantët paraqesin një propozim me e-mail tek adresa ot4d@ifoam.bio ose plotësojnë formularin online (në anglisht ose në shqip)	31 Gusht 2022
3	Propozimi vlerësohet nga Komisioni i Vlerësimit duke përdorur kriteret e përcaktuara të vlerësimit/financimit.	1 – 14 Shtator 2022
4	Aplikanti kontaktohet për rezultatin e vlerësimit. Nëse përzgjidhet aplikimi, planifikohet një takim për të dhënë komente dhe për të rënë dakord për një plan pune dhe kriteret për monitorim.	Mes Shtatori 2022
5	IFOAM-Organics International dhe aplikanti nënshkruajnë marrëveshjen.	Fund Shtatori 2022

5. Monitorimi dhe disbursimi i fondeve

Çdo marrës i fondit të SUOF do të jetë përgjegjës për raportimin mbi aktivitetet e kryera me mbështetjen e Programit OT4D. Këto kërkesa do të specifikohen në marrëveshjen e nënshkruar, përmbajtja dhe formati i raportimit të kërkuar do të jenë pjesë e marrëveshjes.

Në secilin rast, partnerët zbatues lokalë të OT4D, me mbështetjen e IFOAM-Organics International, do të jenë përgjegjës për ndjekjen e aktiviteteve të zbatuara (monitorimi); verifikimin e cilësisë së zbatimit dhe rezultateve të arritura, dhe kontrollin e arritjes së pikave të përcaktuara në propozim. Disbursimet do të lidhen me ecurinë në zbatimin e aktiviteteve.

IFOAM-Organics International është përgjegjëse për disbursimin e fondeve. Përfituesit e grantit janë përgjegjës për dorëzimin e dokumenteve mbështetëse përpara disbursimeve.

Pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve dhe dorëzimit dhe miratimit nga IFOAM-Organics International të të gjitha raporteve të nevojshme financiare dhe narrative, një pagesë përfundimtare do të kryhet brenda njëzet ditësh pune. Në rast të fondeve të papërdorura, marrësit e grantit do t'i kthejnë fondet e papërdorura tek IFOAM-Organics International.

Plani i disbursimit

- 50% pas nënshkrimit të marrëveshjes së grantit
- 30% pas miratimit të progresit dhe raporteve të shkurtra financiare
- 20% pas miratimit të raporteve përfundimtare (operacionale dhe financiare)

Kriteret e vlerësimit sipas komponentit të synuar të projektit

Kriteret e vlerësimit	Pesha
1. Ndikimi në zhvillimin e tregut	35%
2. Ndikimi financiar & qëndrueshmëria	35%
3. Ndikimi social (komuniteti, diversiteti gjinor dhe/ose angazhimi i të rinjve në bujqësi)	10%
4. Rritja e kapaciteteve	20%
<i>Totali</i>	100%

* Rezultati minimal 70%